

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Opština Klokot/Komuna e Kllokot

Datë: 28.06.2019

Bazuar në nenin 12 Neni 12.2 (d); nenit: 40. pika 40.2 paragrafi (1) i nenit: 43. Neni: 45. pika 45.1; 45.2; nenit: 46. Neni 47, pika 47.1; nenit: 48; Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03 / L-040 si dhe Statutin e Kuvendit Komunal të Kllokotit, neni 13 paragrafi 13.3 paragrafi (1); Neni 18, pika 18.3; Neni 20, pika 20.1; Neni 21; Neni 22, pika 22.1; Neni 23 pika 23.1; në seancën e gjashtë të rregullt, Kuvendi i Komunës së Kllokotit sjell:

VENDIM

për dhënien e pëlqimit të Kuvendit të Komunës për zbatimin e procedurës ligjore për ndryshimin e destinacionit të tokës në zonën kadastrale Kllokot nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në emër të pronarit Agron Qerimi nga Ballanca

Neni 1.

Propozim vendimi 864/1 të datës 18.06. 2019, i paraqitur nga kryetari i komunës së Kllokotit, Božidar Dejanović, është miratuar plotësisht nga Kuvendi Komunal në seancën e gjashtë të rregullt të Kuvendit Komunal të Kllokotit, mbajtur më 28 qershor 2019, lidhur me **dhënien e miratimit të Kuvendit të Komunës për zbatimin e procedurës ligjore për ndërrimin e destinacionit të tokës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në zonën kadastrale Kllokot në numrin e parcelës P-73701026-00258-2 në sipërfaqen prej 214 m² dhe parcelës nr. P-73701026-00259-2 në sipërfaqen prej 1286 m² në emër të pronarit Agron Qerimi Zona Kadastrale Kllokot.**

Neni 2.

Kuvendi i Komunës merr vendim për zbatimin e procedurës ligjore në bazë të kërkesës nr. 813 datë: 07.06.2019, të parashtruar nga ana e Agron Qerimit nga Ballanca me numrin ID 1013328826 të dërguar kryetarit të komunës për objektin në titull me qëllim të ndërtimit të një shtëpie në pronën e tij sipas fletës poseduese numër 00258-2 në sipërfaqen prej 214 m² dhe parcelën sipas listës poseduese nr. 00259-2 në sipërfaqen prej 1286 m² zona Katastrale Kllokot.

Neni 3.

Për zbatimin e implementimit të procedurës ligjore për ndryshimin e destinacionit të tokës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore, është përgjegjës departamenti i bujqësisë, pylltarisë dhe menaxhimit të ujërave, si dhe departamenti i kadastrës, urbanizmit dhe gjeodezisë.


Neni 4.

Ky vendim i përmendur në nenin 1 hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga kryetari i kuvendit të komunës së Kllokotit dhe pas vlerësimit të vlefshmërisë së aktit nga ana e Ministrisë kompetente për vetëqeverisje lokale, do të publikohet në faqen zyrtare të komunës.

Kopja :

- MAPL;
- Kabinetit kryetarit komunës ;
- Drej.Bujqësisë,Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave
- Drej.Kadastrit, Urbanizmit dhe Gjeodezisë
- Kryesuesit të K.K.Kllokot
- Parashtruesit të kërkesës
- Arkivës komunale

kryesuesi i kuvendit komunal
Kllokot


/ Zarko Dejanović /
